



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 920 Prot

Tiranë, më 22/7/2020

REKOMANDIM

Nr. 16, datë 22/7/2020

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “AGJENCIA SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E
TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) Zyra e Komisionerit, brenda kompetencave që i njeh ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, është angazhuar në identifikimin e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të cilat disponojnë informacion publik, me qëllim monitorimin dhe nxitjen e tyre për publikimin proaktiv të të gjithë këtij informacioni.

Në këtë kuadër, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare: <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2015/05/PROGRAMI-I-TRASPARENC%C3%8BS.pdf>, të Autoritetit Publik “Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Autoriteti Publik ka detyrimin të vendosi në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) *garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*
- b) *vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet

përditësimit dhe pasurimit të vazhdueshëm. Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik. Veçanërisht i rëndësishëm është publikimi proaktiv dhe lehtësisht i aksesueshëm i informacionit të plotë lidhur me politikat, planet, masat, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse për shërbimet rreth fëmijës dhe familjes të cilat mund të vijnë në ndihmë për parandalimin, identifikimin e hershëm, si dhe trajtimin sa më efektiv të situatave të emergjencës.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar dokumentin e programit të transparencës në ikonën “Transparenca”.

Në mbështetje të neneve 6 dhe 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, nga monitorimi i kryer,

KONSTATOVA SE:

Nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji.

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit por, të pa ndërlidhura me programin e transparencës. Konkretisht si më poshtë:

a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

ç) të dhëna për vendndihjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet t'i përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, në zbatim të gërmeve a), b) dhe c), të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditor nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit".

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22. 7. 2020


KOMISIONERI

Besnik Dervishi



**Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit
Publik/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve – datë
15.07.2020**

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka publikuar Programin e Transparencës në faqen zyrtare në link-un <http://femijet.gov.al/al/wp-content/uploads/2015/05/PROGRAMI-I-TRASPARENC%C3%8BS.pdf>



Programi i Transparencës rezulton i publikuar formalisht por nuk është i pasuruar me asnjë informacion/ informacioni nuk është ndërlidhur me programin e transparencës.

- AP-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohej në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kushtime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AGJENCISE SHTETËRORE PËR MIRATIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE


Kategori e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/ Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a d Ligji 119/2014	Urdhëri i kryeministrit Skema e organigramës Organika	Pas botimit në fletoren zyrtare	Në faqen zyrtare, mençja "Legjislacioni" Në faqen zyrtare.	Burimet njerëzore

				mençja "Rreth ASHIMID"	
Akte ndërkombëtare ligje, akte nën ligjore,	Neni 7/1/b Ligji	Konventa Ligje	Pas botimit në fletoren zyrtare	Në faqen zyrtare në mençje	Sektori i Monitorimit

				mençja "Rreth ASHIMID"	
Akte ndërkombëtare ligje, akte nën ligjore, dokument politikash, dokument tjetër	Neni 7/1/b Ligji 119/2014	Konventa Ligje Akte nënligjore Strategji Raporte	Pas botimit në fletoren zyrtare Pas lancimit	Në faqen zyrtare në mençje "Legjislacioni" Në faqen zyrtare në mençje "Raporte"	Sektori i Monitorimit
Informacioni për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g Ligji 119/2014	Format ankese Shpjeguese Adresa postare Adresa e-mail info@fëmijet.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparencës. Mëqandër në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare në mençje "Program i Transparencës"	Sektori i Monitorimit Koordinatori për informim
Të dhëna për vendndodhjen e zyrtare të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinators për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/q Ligji 119/2014	Shpjeguese Emri dhe kontaktet e koordinators	Pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinators.	Në faqen zyrtare në mençje "Program i Transparencës"	Koordinatori për informim


7.1.a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

Informacioni gjendet i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.



7.1. b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;

Informacioni gjendet i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.



Kodi i Drejtësisë për të Mitur

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përcakton rregullat e përcaktuara ndërmjet me përgjegjësitë penale të të miturve, rregulla procedurale të bërë me heshtje, ndjekja penale, procesin gjyqësor, eksklutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të qendrës tjetër që përfiton që të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmues të veprës penale. Gjithashtu përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 15 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve të nënës së veprës të të Mitur. Kodi i Drejtësisë për të Mitur synon mbrojtjen e interesit të të mitur të fëmijës, integritetin social të tyre, rehabilitimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dëshmues dhe viktimë, parandalimin e viktimizimit të dytë ose riviktimizimit, parandalimin në kryerjen e veprës penale dhe sigurimin e rezultateve publike gjatë administrimit të drejtësisë.

Ligji nr 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

Ligji përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që përson (do fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës. Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë të drejtat dhe aksesin në të drejtat mekanizmat konkrete dhe efektive që garantojnë realizimin me efektivitet të këtyre të drejtave, përkushtimin e posaçmërisht për fëmijët, ngritjen e një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.

Ky ligj sjell një qasje tjetër ndaj mënyrës se si konceptohen të drejtat e fëmijës, në të cilin grupet fëmijësh janë veçanërisht në fokus të shtetit të integruar të mbrojtjes dhe masat konkrete të mbrojtjes që duhet të merren nga struktura përgjegjëse për të parandaluar rehabilituar ose mbrojtur në vazhdimësi fëmijët që është subjekt i dhunës, abuzimit, neglizhencës ose potencialisht i tjetër.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Aktivitetet

2019-03-15

2019-03-15

2018-06-10

2018-06-10

2018-06-10

2018-06-10

2017-12-01

2017-12-01


7.1.c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

Informacioni gjendet i publikuar pjesërisht.

					"Rregull ASHIMI"	
Akte ndërkombëtare ligje, akte nën ligje, dokument politikash, dokument tjetër.	Neni 7.1.b Ligji 119/2014	Konventa Ligje Akte nënligjore Strategji Raporte	Pas botimit në blatën zyrtare	Në faqen zyrtare në menunë "Legislacion"	Sektori i Monitorimit	
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7.1.c.g Ligji 119/2014	Format ankesë Shprehjet Adresë postare Adresë e- mail info@fëmijet.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparenës Mënyrë të ndryshueshme	Në faqen zyrtare në menunë "Program i Transparenës"	Sektori i Monitorimit	per
Të dhëna për vendosjen e zyrtare të autoritetit publik, emrit e punës, emrit dhe kontaktet e koordinimit për të drejtën e informimit.	Neni 7.1.g Ligji 119/2014	Shprehjet Emrit dhe kontaktet e koordinimit	Pas miratimit të udhës të koordinimit të koordinimit	Në faqen zyrtare në menunë "Program i Transparenës"	Koordinatori informimit	per

7.1.ç) të dhëna për vendndihjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;

Informacioni gjendet i publikuar pjesërisht dhe nuk është ndërlidhur me programin e transparencës.



7.1.d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

Informacioni gjendet i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.

Kryetarja

Home / Kryetarja



Znj. ALMA TANDILI

Znj. Alma Tandili ka kryer studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, degë Punë Sociale. Është doktorante në Fakultetin e Shkencave Sociale, Departamenti i Politikave dhe Punës Sociale dhe gjithashtu është e angazhuar si pedagogje e jashtme pranë këtij fakulteti. Tërvojat profesionale kryesore janë fokusuar në fushën e mbrojtjes sociale, kryesisht në çështjet e çrregullimit të komunitetit roman, emigracionit, trafikimit, armatit, të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Znj. Tandili është përfaqësuese e Shqipërisë në Komitetin e Shteteve Palë për monitorimin e Konventës të Këshillit të Europës "Për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual" (Konventa e Lenzarotës) si dhe në Komitetin të holl pas të Drejtave të Fëmijëve në Këshillin e Evropës.

Mrs. Alma Tandili has studied at the University of Tirana, Faculty of Social Sciences, Social Work Department. He is a Ph.D. student at the Faculty of Social Sciences, Department of Politics and Social Work and is also engaged as part-time lecturer at this faculty. The main professional experiences are focused on the field of social protection, mainly in issues of development of the Roma community, immigration, trafficking, education, children's rights and protection.

Mrs. Tandili is a representative of Albania in the Committee of States Parties for the monitoring of the Council of Europe Convention "On the Protection of Children against Sexual Exploitation and Sexual Abuse" (the Lanzarote Convention) and the ad hoc Committee on the Rights of the Child in the Council of Europe.

ORGANIKA E AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
KRYETAR (TITULLARI I INSTITUCIONIT)	II-b	1
SEKTORI PËR MBROJTJEN DHE MONITORIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	3
SEKTORI I KOORDINIMIT DHE STATISTIKËS		(2)
SPECIALIST	IV-a	2
PUNONJËS GJITHSEJ		7

7.1.dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.

Informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës dhe nuk është i përditësuar.

Buxheti

Home / Buxheti

- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2011
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2012
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2013
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2014
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2015
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2016
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2017
- PLANI I BUXHETIT PËR VITIN 2018
- REGJISTRU PARASHIKIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2015
- REGJISTRU PARASHIKIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2016
- REGJISTRU PARASHIKIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2017
- REGJISTRU PARASHIKIMEVE TE PROKURIMEVE PUBLIKE PER VITIN 2018



You may also like



Mbrojtjen
Fëmij

Mbrojtjen
Fëmij

Mbrojtjen
Fëmij

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

7.1.ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

Informacioni gjendet i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.

Formulari i Ankësës

Protokoluar me Nr. _____, datë _____

FORMULARI I ANKËSËS

Ankuesi: Emri _____
 Mbiemri _____
 Adresa _____
 Telefon _____

Drejtuar: Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
 Rruga Kavajës, Nr. 1001

Tiranë

Përmbajtja e ankësës:

a. Të dhëna për subjektin për të cilin ankoheni ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij

b. Veprimet ose mosveprimet e subjektit që i konsideroni shkelje

7.1.gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji. Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh; Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqe.

7.1.l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Informacioni gjendet i publikuar në faqe por nuk është i ndërlidhur me programin e transparencës.